



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E ADMINISTRATËS

Në mbështetje të nenit 62.3 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenin 64 paragrafi 4 të Statutit të Komunës nr.prot.01/020/01-0050862/18, bën këtë;

FTESË PUBLIKE

Për

Nominimin e një anëtari/e nga radhët e Shoqërisë Civile

Rregullorja për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Podujevës, përcakton themelimin e Komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave Lokale, në kuadër të të cilit parashihet edhe 1 (një) anëtar/e përfaqësues nga radhët e shoqërisë civile.

Andaj, ftohen shoqëritë civile të paraqesin nominimet e anëtarëve të tyre të interesuar, dhe atë çdo ditë **pune duke filluar nga data: 24.10.2022 deri më 28.10.2022, nga ora 08:00 deri në orën 16:00,**

Dokumentacioni dorëzohet në Drejtorinë e Administratës, përmes Qendrës së Shërbimit me Qytetarë.

Nominimi/et do të prezantohen në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, ku edhe do të bëhet zgjedhja e 1 (një) anëtari/e nga radhët e Shoqërisë Civile në Komisionin përkatës.

Për informacione shtesë mund të kontaktoni, si në vijim:

Adresa elektronike: antoneta.ejupi@rks-gov.net;

Tel. 038 200 41 002 - brenda orarit të rregullt të punës

Podujevë,
21 tetor 2022

